



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **17.09.2019**, me fillim në ora **10.20**.
Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, Nënkryetarin **Fatmir Iska**, delegatët e pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e OSBE-së, gazetarët, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi. Ju paravë rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të mbetura nga buxheti i vitit 20019,**
3. **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me sipërfaqe prej 11000 m²,**
4. **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me sipërfaqe prej 25099 m²,**
5. **Shqyrtimi i Propozim Buxhetit si dhe KAB-it për vitin 2020-2022,**
6. **Shqyrtimi i planit strategjik Komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Rahovec 2020-2024,**
7. **Te ndryshme,**

Kryesuesi – E vë në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e kaluar.

Kryesuesi - A ka dikush të shtoj diçka rreth procesverbalit, nëse nuk ka, urdhëro z.Cena.

Fehmi Cena-Faleminderit Kryesues, përshëndetjet për të gjithë të pranishmit, unë materialin që e kam marr vetëm kam parë që ka shtesë, n'fakt duplikim të disa shënimeve po e zëmë është faqja e katërt është e duplikuar dy herë, pra ajo duhet të hiqet dhe kjo është në rregull.

Kryesuesi- Faleminderit shumë, tjetër dikush? Nëse jo atëherë e qesim në votim pikën e parë, kush është për, faleminderit kundër jo, abstenim jo, konstatohet se aprovohet pika e parë. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

2.Shqyrtimi i Propozim - vendimit për ridestinimin e mjeteve të mbetura nga buxheti i vitit 2019,

Kryesuesi- për këtë pikë ftoj drejtorin z. Afrim Limani

Afrim Limani - i nderuar kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar anëtar të KPF-së, përfaqësues të OSBE-së dhe gjithë të pranishmit. Për dallim prej herëve tjera, viteve tjera kësaj radhe dokumentin e ridestinimit të mjeteve e kemi bërë në muajin shtator, për arsye të shumta sepse procesin e destinimit të mjeteve do të thotë si proces në kuadër të Ministrisë së Financave kryhet gjatë muajit tetor dhe ne e dijmë të gjithë se seanca e Kuvendit mbahet gjithmonë ka fundi i vitit edhe viteve tjera kemi rrezikuar kështu që kësaj here, kemi menduar më mirë më pozitivisht dhe që ta kemi si dokument të gatshëm edhe të jemi përgatitur me kohe.

Shuma e mjeteve për ridestinin është 348670 euro do të thotë ne jemi bazuar në nenin 30 të ligjit të Financave Publike dhe përgjegjësive kryesisht nenin 80, e kemi përgatitë këtë dokument, do të thotë me këtë vlerë totale. Në çdo drejtori kemi bartje, ridestinin të mjeteve dhe ky ridestinin është bërë me arsye të caktuar, për njërën apo tjetrën dhe konsideroj se kjo është bërë me vend edhe e kemi përgaditur këtë dokument në mënyrë që këto mjete të mos rrezikohen të shkojnë në suficit, do të thotë sikur të mos kryhet ky proces atëherë ky total i mjeteve do të rrezikohet të shkojë edhe në suficit. Procesi i rishikimit të buxhetit siç e dijmë ne të gjithë sivjet nuk ka pasur rishikim të buxhetit mirëpo fatbardhësisht që është destinimi ndoshta është më i nevojshëm më i qëlluar sepse ndoshta në fazën e parë të rishikimit, në fund të muajit qershor dhe faktikisht ne nuk mundemi me ditë gjendjen e disa projekteve atëherë fatbardhësisht që është edhe ridestিনি dhe ne duhet të kryejmë këtë proces të mos rrezikojmë do të thotë që këto mjete të shkojnë në suficit. Në monitor e kemi këtë dokument që shihet më mirë dhe pres ndonjë pyetje apo ndonjë sqarim nga ana e juaj. Faleminderit

Kryesuesi-Faleminderit shume drejtor, urdhëro z. Fazliu!

Rasim Fazliu- Faleminderit Kryesues, përshëndetje për juve, Nënkryetarin, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësues të OSBE-së, LBT-së, mediave, drejtorët dhe gjithë të pranishmit tjerë kush janë këtu. Ne e dimë që çdo herë vjen deri te ajo që duhet të ridestininohen mjetet për mos me shku qysh e tha edhe drejtori në suficit mirëpo të them të drejtën për mua është pak interesant që në bazë të disa projekteve këtu që po i shoh unë, a është planifikuar keq fillimisht ato mjete e s'kanë mundur të realizohen apo çka ka ndodhur këtu, pse me ardhë deri këtu, marrim shembull ndërtimin e rrugës Drenoc-Zatriq, pse kanë mbetur këto mjete, është një pyetje për drejtorin pse kanë tepruar këto mjete, rruga e dimë që është kryer moti apo janë paraparë mjete ma shumë se sa duhet aty apo çka është puna ose të njëjtën gjë e kemi te ndërtimi i rrugës Celinë-Nagavc edhe kjo moti është përfunduar qysh mandatin tonë, para dy viteve ka përfunduar, ne tash kemi këtu mjete tepër që kanë mbetur dhe i detyrohet me shku ose me i ridestinu ose me shku në suficit, e mos të flasim për disa projekte tjera veç po du me i analizuar pak, ku e kam fjalën, shembull e kemi te bujqësia, po dal konkretisht aty për ridestinin, d.m.th. ta marrim projektin ka qenë ulja e niveletës së përroit në fshatin Celinë, kodi 46683, janë 63416 euro për ridestinin, kur dihet se ai përrua ende nuk është i përfunduar d.m.th. ka pas mundësi që ato mjete të vazhdojnë në atë projekt, pse të shkojnë ato në suficit, pse nuk i është thënë operatorit t'a vazhdojë punën, e kemi edhe në drejtim të fshatit të nalt, po ashtu edhe poshtë andej ka Drini, d.m.th. këto janë pak mjete sa duhet aty për mu krye ai projekt krejt, tash ju kemi nënshtruar asaj në qoftëse ne sot, po mendoj në mbledhje të Kuvendit nuk e miratojmë atëherë këto shkojnë në suficit d.m.th. kjo është e gjitha, pse nuk janë hargjuar këto mjete në projektin që duhet, të kësaj natyre ka edhe shumë projekte tjera, konkretisht po e marrim kanal, ju kërkoj falje pse po lidhet prapë me fshatin Celinë, kanali i kullimit të tokave bujqësore ne fshatin Celinë dhe Fortesë kodi 46624, gjithashtu 35000 euro d.m.th. kjo për mua është pak e papranueshme sepse kullimi i tokave jo në Celinë por edhe në të gjitha fshatrat përreth aty nuk është i zgjidhur jo vetëm në këtë mandat, por edhe në mandate tjera janë munduar me bo zgjidhje por ende thuajse që është në fazën fillestare puna nuk është bërë ku me ditë çka, ndonjë zgjidhje e përhershme a kështu mjetet kanë mbetur edhe duhet me i ridestinuuar në projekte tjera, e unë konkretisht mendoj që është gabim, këto mjete me i qu në projekte tjera kur mundeni veç me i vazhduar në të njëjtat projekte, p.sh. konkretisht këto që i përmenda e kanë paraparë të shkojnë në vende tjera ose në projekte tjera, imagjinoje këto projekte kapitale p.sh. përkrahja e fermerëve në komunën e Rahovecit me mekanizma bujqësorë etj., d.m.th. për mua është e papranueshme kjo, por kontribut më të madhe do të japim në mbledhje të Kuvendit, unë vetëm i shpreha pakënaqësitë e mia rreth ridestinitimit të mjeteve, nuk jam duke bërë pyetjen pse kanë mbetur sepse mbesin ne çdo qeveri mbesin mjete d.m.th. për një arsye apo për një tjetër nuk realizohen mirëpo projektet kapitale që janë dhe vërtetë që janë të domosdoshme të kryhen nuk kanë përfunduar, kanë mbetur në gjysmë ose nuk janë nisur hiq p.sh. kanali i kullimit të arave në Celinë nuk është nisur hiq, ajo është vetëm përroi që është rregulluar d.m.th. a në këtë pjesën tjetër që kemi që kanë me u vazhduar, që i dimë edhe ne edhe qeverisja komunale, por nuk po zgjatim më shumë, në mbledhjen e kuvendit sigurisht se do ta diskutojmë edhe më gjerësisht edhe do të flasim më tepër .Faleminderit shumë.

Kryesuesi- Faleminderit shumë z. Fazliu, tjetër dikush? Urdhëro z. Cena!

Fehmi Cena- Faleminderit Kryesues, do të thotë përpara e kemi një dokument në lidhje me ridestinimin e mjeteve të mbetura nga buxheti për këtë vit, drejtori i dha disa sqarime por ai i dha të cekëta nuk shkoj hollësisht që për ne ndoshta është me rendësi me i sqarua të gjitha këto për me i pas më të qarta, e kuptoj ridestinimin se normal duhet të parashihet se buxheti nëpër dikastere të caktuara nuk është shpenzuar aty ku është planifikuar më herët dhe pastaj është e drejtë e tyre për me planifikuar për ndonjë shfrytëzim tjetër por brenda drejtorisë, sa po shoh unë d.m.th. çdo mbetje apo kërkesë për ridestinin prapë brenda drejtorive të caktuara ose shërbimeve të caktuara është. Natyrisht edhe ne e ndajmë shqetësimin e njejtë, është sigurisht detyrë e qeverisë komunale se kur bën planifikimin fillimisht të jetë më i saktë në mënyrë që të mos mbetet një shumë e madhe e parave dhe pastaj të shikohet të bëhet ridestিনি. Unë isha ndalur pak të shërbimet publike të kërkojmë një sqarim, po e zëmë është një shumë goxha e madhe mbi 50.000 euro që po kërkohej ridestini, në rregull është të përmendet kanalizimi në Pastasel, ndriqimi publik, nuk po e shoh në Rahovec disa herë e kemi përmend për lumin Dullo faktikisht një kolektor është përmendur edhe më herët që është mëse i domosdoshëm për përpunimin e ujërave të zeza për arsye se ky lumë është shndërruar pothuajse në një formë kanalizimi edhe duhet të shikohet, ishin goxha mjete edhe ndoshta kishin mjaftuar për një kolektor ose pjesë të tij ku do të bashkëngjitej edhe pjesa tjetër e buxhetit që është e paraparë për këtë kolektor

sepse mua nuk më kujtohet tash shuma që është paraparë për këtë vite mirëpo e di që kom pas vërejtje se ka qenë një shumë e vogël, nuk e di a është marr parasysh kjo. Te bujqësia të ridestini poshtë pika 2 ndërtimi i infrastrukturës për tregun e rrushit 10.000 euro, po me intereson cili treg është i rrushit, ku është ky treg i rrushit nuk e kam të qartë, tash le të na sqaron drejtori, është një pikë p.sh. të urbanizmi, planifikimi dhe mbrojtja e mjedisit, krijimi i hapësirave të gjelbëruara me drunjë dekorativ, hapësirave të gjelbëruara, mendoj që kërkesa ime është që kur bëhet ridestini i këtyre të hollave është mirë që drejtoritë përkatëse jo në aspektin e përgjithshëm me përmend p.sh. hapësirave të gjelbërta por edhe me specifikua pak a shumë sepse ata duhet me pas planin e punës gjatë vitit, ku kanë paraparë më shumë këto hapësira të gjelbërta? Ku i japin prioritet a në qytet apo në fshat? A në cilën lagje që na me pas më të qartë edhe pastaj e krijojmë atë bindjen tonë. Pastaj për drunjë dekorativ ne kemi pas edhe mjaft vërejtje, se ata drunjë dekorativ që janë mbjellë vitin e kaluar, gjysma munden me garantua se vetëm janë tharë ndoshta do të thahen edhe krejt, kemi kerkuar mirëmbajtjen e tyre, nuk e di si shkohet, tash nëse vazhdojmë me investuar edhe ata, që nuk janë edhe pak, 90.000 euro mbjellin drunjë vitin e ardhshëm që 70-80 %, thahen atëherë do të jetë një dështim edhe herave tjera do të jetë një pikëpyetje a do të lejojmë na me u mbjellë më drunjë dekorativ në qoftë se nuk është në gjendje komuna me i mirëmbajta ato. Te shëndetësia, dezinfektimi, dezinfektimi do të thotë shuma e aprovuar prej 30.000 euro që ne kemi përkrahë dhe tashti po kalon në vitalizimin e infrastrukturës për funksionalizimin e projektit shtretërit shtëpiak, por në rregull veç po me intereson çka është bërë me këtë projekt, a është bërë apo nuk është bërë sepse po shihet se të gjitha ato të holla po kalojnë kënde. Kaq për sot, mendoj që në mbledhjen e ardhshme vetëm kisha kerkuar që në mbledhjen e ardhshme drejtoritë me i specifikuar këto shpenzime më saktësisht, me i cek edhe projektet ku janë, cilat janë e kështu me radhë.

Kryesuesi-Faleminderit shumë z. Cena, tjetër dikush, urdhëro z. Qadraku!

Dervish Qadraku- Përshëndetje kryesues, ju anëtarë të Kuvendit, kolegë të pranishëm këtu, edhe unë i kam vërejtjet e mia, sikur që i patën edhe parafolësit tanë këtu- kolegët e mi edhe për shumëçka pajtohem për vërejtjet që kanë, por megjithatë unë duhet t'i them dy tri fjalë në lidhje me këtë ridestini. E para punës, që unë mendoj që nuk është në rregull është që nuk kemi nga drejtori arsyetimin se pse këto mjete kanë mbetur, a janë mbetje të projekteve të përfunduara, që rrallë herë ndodh që ka mbetje të mjeteve nga projektet e caktuara, dhe e dyta punë është që pse këto projekte, në qoftëse ndonjë projekt ka dështuar siç është p.sh. rasti me dezinfektimin që d.m.th. 30.000 euro janë ndarë, dhe me sa di unë në terren nuk është realizuar ky projekt, këtu kemi edhe raste tjera, në anën tjetër këtu i kemi ndoshta edhe të padefinuara si kode të veçanta, i kemi të padefinuara mirë, mendoj që është mirë t'i caktoni taman kodet sepse po përzihen gjërat këtu, siç është rasti këtu. Ndërtimi i Rugës Drenoc-Zatriq, që unë e di që kjo rrugë është e ndërtuar, nëse ka të bëjë me meremetimin, atëherë duhet të shkruhet- Meremetimi i Rugës Zatriq-Drenoc ose Ndërtimi i Rugës Celinë -Nagac, mendoj që nuk është e drejtë emërtimi sepse nuk kemi të bëjmë me ndërtimin sepse ndërtimi është mbaruar ne kemi kaluar disa herë nëpër atë rrugë edhe të Drenocit edhe të

Celinës, prandaj është mirë që kjo të definohet më mire edhe drejtori të na shpjegojë më qartë në lidhje me këto mbetje të parave nëpër kode ose p.sh. kemi te shtruarja e rrugëve lokale me kubëza, unë mendoj që paraprakisht drejtori dhe gjithë kolegët e kanë ditur që do të kenë mbetje përafërsisht, sepse kanë qenë të njoftuar prandaj është dashtë të ne këtu me projekte të caktuara për vende të caktuara, ku do të shpenzohen këto para sepse në mënyrë të përgjithësuar atëherë lind dyshimi se ka po shkojnë këto dhe ne nuk kemi kontrollë sa i takon si kuvendarë se ku do shpenzohen këto para sepse neve do të na pyesin qytetarët me këto mbetje çka keni bërë edhe ku po i dërgoni, ne nuk kemi përgjigje për këto sepse nuk e dimë. Ose ke raste p.sh. te rasti i Pastaselit, i ke mbi 30.000 euro për Pastaselin dhe kanalizime tjera, me mbi 30.000 euro duhet të ndërtohet kanalizimi i ri dhe ndoshta është problem për ti arsyetuar këto mjete që do të shkojnë në meremetimin e kanalizimit. Tash meremetimi ka kosto tjetër ne raport me kanalizimin e ri ose kemi projektin, ujërat siç e tha edhe kolegu më përpara, në Celinë 63.000 euro. Si ka mundësi me mbetë këto mjete, çfarë projekti apo çfarë përlllogaritje është bërë, që këto para edhe përkundër që është përfunduar apo nuk është përfunduar që tash spo e di saktë, sepse edhe nuk jam kompetent me i përcjellë ato atje d.m.th. është shumë para e madhe që ka mbetur pa u shfrytëzuar, nëse është kështu edhe ke pastaj sistemin e ujitjes në komunën e Rahovecit, kodi 47844 (45.000 euro), këto tash a kanë mbetur apo s'keni filluar hiq të implementoni këtë projekt sepse Rahoveci dhe rrethina kanë nevojë për sistemin e ujitjes, me mbet 45.000 euro është një arsyetim që nuk mundesh me arsyetuar para qytetarëve prandaj unë mendoj që tjera herë le të vijmë pak më të kompletuara, më konkrete, në mënyrë që ne të kemi çka të flasim. Unë kisha dhënë propozim tash edhe për këto mjete që ju i keni destinuar, unë kisha dhënë propozime të reja nëse më lejohet, të paktën unë kam të drejtë të propozoj, që një pjesë të këtyre parave ti redestinojmë nëpër vende të caktuara, të cilat e luajnë një rol shumë të rëndësishëm për qytetarin si p.sh. ne e kemi të shkruajtur këtu që për 2020-2022, do të ndërtohet ashensori në 5.000 euro për vitin 2021, dhe 5.000 euro për vitin 2022, hajgare është kjo punë, një ashensor që marohet në komunë pra në korridorin e komunës që po dihet se për çka marohet ai për një kategori të caktuar të qytetarve edhe tash dy vjet neve na duhet dhe prej vitit 2020-2022 për mos me mujt me marue ka 5000 euro e na e dimë sa mundet me kushtue një ashensorë dhe sa emergjent dhe sa i nevojshëm është ai prandaj është mirë që një pjesë të këtyre mjeteve me ndae edhe për këtë ashensor që të kryhet sivjet kjo punë dhe kjo kategori e qytetarve të mos konsiderohet si e shkelur apo e dëmtuar në këtë drejtim ,po ashtu unë kam folur edhe ma herët për punën e parkingut ,ne pop bajmë reklamë kur po vijmë qytetaret nga diaspora qe po i lëshojmë 2-3 vende për parkingje të diasporës kur kemi mundësi ajo pjesa atje e ish gjimnazit me 4-5 mijë euro t'u rrafshuar edhe adaptuar për t'u bërë përkohësisht për një parking të qytetarëve që vijmë nga diaspora edhe lirohet edhe kjo pjesa këtu, pse mos të bëhet tash kjo me këto mjete deri sa i kemi këto mjete të mbetura të papërdorura. Është edhe një e rëndësishme që nuk shoh këtu në projektet tona të komunës tek libri, Biblioteka e qytetit tonë i ka në fakt 3.000 tituj sa i ka dikund 15.500 ekzemplarë, tash komuna e Rahovecit nëse i pjesëtojmë me librat që kemi sa banorë kemi, askund hiq s'jemi sa i takon librave, furnizimit të qytetarëve me libra, aq më tepër, unë do të kërkoja nga drejtori i Arsimit që të na jep një pasqyrë neve, se sa libra ka nëpër shkolla që janë në dispozicion të qytetarëve, po mendoj të nxënësve që i kanë në dispozicion për ti lexuar, dhe sa kabinete të shkollave i kemi të kompletuara të cilat këtu asnjë cent nuk e kemi ridestinuuar? Sa kemi kabinete ose vende që nxënësit kanë mundësi që përmes mësuesit të tyre, që me mjete konkretizuese të ju shpjegohet për gjëra të ndryshme ose për ligje të ndryshme të fizikës, kimisë, biologjisë etj. Prandaj unë mendoj që është mirë që edhe këto pare që na kanë tepruar po them kushtimisht unë, me i ridestinuua edhe në këtë drejtim, do të ishte mirë dhe do të ishte në një farë mënyre edhe e lëvërdishme edhe për qytetarin edhe këto pare vërtetë kontributdhënëse dhe qytetari do të na dinte për nder dhe do të përfitonte nga këto. Kaq për këtë moment dhe ju faleminderit shumë.

Kryesuesi- Faleminderit shume z. Qadraku, po zonja Lushi.

Fahrije Lushi-Faleminderit Kryesues, të nderuar kolegë nga KPF, drejtorë dhe gjithë të pranishëm .Mjetet për ridestininim është e arsyeshme ndoshta me thënë ti redestinojmë, ti kthejmë prapë d.m.th. t'i shpenzojmë mirëpo çka është ma e pakapshme dhe thjesht që don një sqarim pak më të vërtetë pak me konstituiv sepse p.sh. e kemi rastin te Kulturë, Rini dhe Sport dhe thjeshtë ndoshta dikush tjetër edhe e di edhe më mirë se unë mirëpo thotë se restaurimi i objektit përkujtimor për 64 të masakruar në Krushë të Madhe, kodi 48201 (5.000 euro), ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike në Rahovec, kodi 48175 prapë 5.000 euro,

edhe kur vije shuma do të ridestinohet edhe 10.000 euro, pse kanë tepruar këto edhe pse nuk janë realizuar sepse kjo punë është bërë me një planikim dhe thjeshtë e kërkon një arsye me domosdoshmëri, sepse nëse e dimë që mund të ketë vonesa edhe s'kanë filluar projektet me kohë mirëpo që shuma të ridestinohet komplet këtu është diçka që thjeshtë kërkon sqarim. Faleminderit!

Kryesuesi- Faleminderit shumë znj. Lushi, tjetër dikush? Atëherë nëse nuk ka tjerë të lajmëruar ndoshta drejtori apo dikush prej drejtorëve që u ngritën çeshtjet, urdhëro drejtor!

Afrim Limani - Fillimisht deshta me ju përgjegj një pyetje që e ngrihti doktori, por paska dal jashtë, por pa marrë parasysh do të arsyetohem, nuk dhash sqarime më të hollësishme sepse unë nganjëherë tentoj me qenë komod i madh edhe kjo del jashtë kufinjëve për punë, që mos ju marr kohë deri sa e kemi në monitor e kam lënë hapësirën edhe për pyetje edhe për atë ndoshta nuk kam dhënë arsyetime më të hollësishme mirpo mua më iku një gjë që u desht me thënë më herët e ky proces në bazë të Ligjit të Financave dhe përgjegjësisë në kuadër të një programi, po supozoj Drejtoria e Bujqësisë do të thotë krejt shuma e mjeteve ka drejtë me u terheq me një projekt tjetër, do të thotë projekt që është me kod, në total i ka 100 000 euro ka drejtë me i terheq mirëpo prej Bujqësisë nëse duam me i bartë në Financa ose në Ekonomi atëherë kjo lejohet vetëm 15% në bazë të Nenit 30 të Ligjit të Financave Publike dhe përgjegjësisë edhe mundem të them se, Fahrija ja përcjell doktorit, kërkoj falje por nganjëherë tentoj me qenë komod. Doktor, kritikë me vend, ju thashë edhe kolegëve tu, unë nganjëherë tentoj me qenë komod i madh edhe me ikin disa gjëra, për atë unë nuk dhashë sqarime më të hollësishme duke e ditur që të mos ju marr kohën edhe lash hapësirën për pyetje, mirëpo unë një gjë e harrova me thënë është shumë kryesore do të thotë shuma e mjeteve në kuadër të një programi bëhet në total, po supozojmë 100.000 euro i kemi, të njëjtën shumë kemi të drejtë me bartë në kuadër të atij programi, do të thotë drejtorie, mirëpo nëse duam me i bartë shumën prej një drejtorie në drejtorinë tjetër, atëherë në bazë të Ligjit të Financave Publike dhe përgjegjësisë do të thotë kjo shumë është 15% që na lejohet, e për atë kërkoj falje. Fillojmë me radhë, mësuesi i bëri disa pyetje, e para ishte pse ka tepriçë të mjeteve në rrugën Drenoc - Zatriq dhe rruga Celinë - Nagavc, do të thotë po hyjmë te Drejtoria e Shërbimeve Publike, në fund të vitit të kaluar ne kemi pasur një mbështetje nga Ministria e Financave me vlerë 300.000 euro edhe atë shumë pikërisht e kemi shpërndarë në këto projekte, do të thotë në dy këto projekte edhe në disa projekte tjera edhe sado kudo kjo e ka zbutur kontratën, edhe ato mjete të cilat i kemi pasur të planifikuara për vitin 2019 atëherë këto mjete janë ridestinuara, që unë në fillim thashë çdo bartje e mjeteve, ridestininim, i ka arsyet e veta do të thotë secili projekt i ka arsyet e veta, po tash pyetja shtrohet pse janë bartur në këtë projekt, janë dy arsye kryesore që janë bartur në kuadër të një projekti, e para mbyllja e kontratave me vlera të vogla 12.000 dhe 20.000 euro, do të thotë po e mbyllim një kontratë edhe mënyra tjetër do të thotë, është sepse kemi kontrata ma të mëdha dhe sado kudo edhe me zbutë edhe kontratën, do të thotë kështu janë orientuar edhe drejtorët. Pastaj pyetja tjetër ishte pse këto mjete me mbete në kuadër të uljes së niveletës së përroit, për projektin që nuk është kry më së miri ndoshta mundet me të dhënë sqarim drejtori mirëpo siç e dini mësues, nëse skeni harruar, do të thotë në procesin e rishikimit d.m.th. bartja e mjeteve që është bërë në shkurt, ne i kemi pas bartur edhe disa mjete në kuadër të këtij projekti dhe sa e di unë ka qenë edhe kërkesë e juaja edhe ato mjete e kanë rritur edhe vlerën e projektit dhe këto mjete.

Rasim Fazliu - Unë shumë i qartë jam, projekti pa përfunduar, u punua sa u punua, shumë në rregull, kanë mbetur mjetet, keni paraparë edhe mjete tjera që keni dërguar aty, po pse këto nuk po vazhdojnë në të njëjtin projekt po mi dërguar në Ratkoc apo ku ta di unë.

Afrim Limani - Detajet e kontratës më së miri i di menaxheri i kontratës, do të thotë na u mbyll kontrata, kemi tepriçë të mjeteve edhe për të edhe kemi ridestinuara, pyetja tjetër ishte kanali i kullimit të tokave bujqësore në Celinë dhe ke qenë edhe ti asambleistë edhe në atë periudhë, kjo kontratë është një kontratë që e kemi trashëguar nga viti 2013, që janë kryer disa punë dhe ka ardhur koha me i ndërprerë, me bërë një revizion të projektit, doktorit i dhash një përgjigje që ishte një pyetje, ndërtimi i infrastrukturës te tregu i rrushit, do të thotë ky treg është te Stone Castle aty ku po organizohet edhe festivali, edhe i kemi bartë edhe këto mjete këtu vlera ishte 12.000 euro, realisht që thash edhe në fillim po mbyllet edhe kontrata, ne me këto mjete po e mbyllim kontratën në kuadër të këtij projekti. Pyetja tjetër ishte pse ka dështuar pra po bëhet bartja e mjeteve në kuadër të projektit në Shëndetësi, dezinfektimi, dezinfektimi. Doktor në këtë projekt, ka prilli e kemi hapur mirëpo ka pasur ankesa nga operatorët e ndryshëm dhe lënda është akoma në OSHP,

edhe ne nuk guxojmë me prit nëntorin sepse këto mjete shkojnë në suficit edhe sikur të kryhet ky proces, ta fitoj dikush atëherë veç procesi i dezinfektimit ne veç e dimë edhe koha kur është sezona dhe ne e kemi parë të arsyeshme që këtë projekt ta bartim ashtu siç është i shkruar. Dervish, besoj që disa përgjigje që ju dhash këtyre, ato vlejnë edhe për ty edhe një pyetje ishte më interesant, do të thotë sistemi i ujitjes 45.000 euro, ne kemi rekomandim nga Radoniqi bashkë me APL-në që në këtë projekt nuk guxojnë të investojnë sepse Radoniqi e paska fituar një projekt të madh, do të thotë nga Komisioni Evropian që ka për objektiv ndërrimin e krejt rrjetit egzistues që është, do të thotë me bo më të mirë, me standart dhe për këtë arsye ne nuk guxojmë dhe nuk na kanë lejuar të investojmë, sepse investimi jonë aty është 49% me 51% dhe kjo është arsyeja dhe ne kemi planifikuar më herët se sa e kemi pas këtë informatë dhe kjo është arsyeja, do të thotë që jemi detyruar t'a bartim këtë ridestininim të mjeteve. Procesi i ridestininimit të mjeteve kryhet në kuadër të vitit aktual fiskal, projektet të cilat janë edhe me kode egzistuese, tashti ato mundemi t'i diskutojmë në pikën e buxhetit, tash realisht disa projekte p.sh. më kujtohet furnizimi me libra që e diskutove ti që kërkove shumë, ne e kemi atë projekt në kuadër të drejtorisë së Kulturës dhe më vonë në pikën e buxhetit mundesh me i ngritë edhe këto çështje që i diskutove, tash është fjala pikërisht për projektet që janë në vitin aktual fiskal që kanë edhe kodet e veta, do të thotë këtu bëhet lëvizje, për ridestininim që thash edhe në fillim do të thotë prej këtij kodi në atë kod, që është në sistemin PIP në kuadër të investimeve kapitale. Fahria pyeti në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, një projekt Restaurimi i Objektit për 64 të masakruarit në Krushë edhe këtu jemi detyruar të bëjmë bartjen e mjeteve sepse akoma nuk kemi mundur të privatizojmë, nuk kemi mundur që atë pjesë me vu në kuadër të komunës, ka probleme të ndryshme edhe spo du të futem më gjërë edhe fjala është pikërisht që s'kemi mundur t'a fusim atë pjesë si pronë komunale sepse pa e bërë këtë veprim ne s'kemi të drejtë me investua sepse menjëherë auditori e cilëson si keqklasifikim.

Kryesuesi –Faleminderit drejtor për sqarimet,urdhëro z. Fazliu!

Rasim Fazliu- I nderuari drejtor, unë të kuptoj, besoni që nuk po flas sepse tash jemi në zgjedhje edhe dikush mund ta merr se tash është fushata edhe po e bëjmë për zgjedhje, besoni që absolutisht hiq ska lidhje me zgjedhje, konkrete biseda ime është konkrete edhe kjo po bie që dy vite janë paraparë projektet pra mjetet, nuk është nisë projekti edhe mjetet prej atij projekti barten në projektin tjetër, shkurt shqip troq nuk kemi këtu dika tjetër dhe kjo po i bie fiks fare qashtu d.m.th. janë paraparë mjetet për atë projekt konkretisht kullimi i tokave, e projekti nuk është nisur hiq që tha Dervishi, pse kanë tepruar? Nuk kanë tepruar por nuk është nisur projekti hiq edhe prej atij projekti i kanë gjuajtur tjetër ka me një projekt tjetër dhe kjo nuk është në rregull edhe sa për sqarim edhe këta tjerët që janë të rinj këtu, ky projekt konkretisht, Kullimi i tokave bujqësore është ndërprerë në qeverisjen e Idriz Vehapit, është ndërprerë për shkak se ka qenë projekt gabimisht i planifikuar, ka shkuar puna krejt gabimisht edhe tash për me ju ikë përgjegjësive e kanë ndërprerë këtë projekt, e tash kur janë paraparë këto mjete, tash është dashur të filloj për se mbari edhe të përfundoj ky projekt e jo me i gjujt mjetet pa ja nis punës hiq ose mos i parashih me kohë d.m.th. edhe kjo bën. Ju faleminderit!

Kryesuesi- Faleminderit, po drejtor!

Berat Duraku-Faleminderit kryesues, përshëndetje për anëtarët e KPF-së, Nënkryetarin, gjithë të pranishmit! Po lidhem direkt me këto të kanaleve të kullimit se ka te drejtë mësuesi se kanë qenë goxha të komplikuar. Kontrata e parë që është lidhur për kullimin e tokave bujqësore ka qenë në vitin 2013, kanë filluar punimet aty edhe menjëherë ky projekt ka hasur në pengesa për arsye të ndryshme, pak për fajin se ndoshta projekti s'ka qenë i mirë po ashtu edhe banorët nuk kanë lejuar me u zhvilluar punimet d.m.th. ka pas disa arsye që janë ndërprerë punimet, ndërkohë ka ndodh një revidim i projektit, me atë revidim janë kryer prapë punimet. Kur kemi ardhur ne, këtë projekt e kemi gjete të hartuar prej ish-qeverisjes përveç se ne e kemi bërë ndryshimin ose revidimin e projektit edhe e kemi përfshirë pjesë me beton, ka qenë vetëm hapja e kanalit ose ulja e nivelit vetëm të hiqet dheu. Gjitha tokat aty janë të drenazuara, problemi ka qenë se gypi i fundit i drenazhit ka qenë i mbyllur, tash me hapjen e niveletës pra me uljen e nivelit dhe hapjen e gypit të drenazhit, projekti i cili deri vitin e kaluar i ka marrë gjitha ato toka prej vërshimeve më nuk ka pas telashe edhe nuk ka me pas telashe në të ardhmen d.m.th. pasi që u lirue dalja e gypit të drenazhës, çka ka mbet aty tash ulja e niveletës vetëm pastrimi deri në fund të Drinit edhe ky projekt llogaritet i përfunduar, pra më shumë këtu edhe ja zgjatë metrat, nuk ka qenë 1237 metra kanal me beton me ato dimensionet qysh janë,

pra janë zgjatur diku për 140 metra si për atë pjesën përmbi por edhe në fund jashtë servisit atje në fund, ke drejtë që thua ajo pjesa e epërme por jo me fondin e bujqësisë, sepse aty është vendbanim dhe aty le të merret Drejtoria për Urbanizëm, Drejtoria e Shërbimeve Publike, fondin e Bujqësisë nuk na lejohet neve me investua nëpër fshatra, për shkak se nëse duam me bo kullimin e tokave atëherë duhet me marr fondin e Bujqësisë, nëse është për vendbanim Urbanizmi, Shërbimet Publike. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë drejtor, ndoshta është kon mirë Drejtorinë e Financave, mos është bërë një gabim teknik këtu te Drejtoria e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Turizëm për të përmirësuar këtë, faleminderit shumë për kontributin, konstatoj se pika e dytë e rendit të ditës kalon për Kuvend, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

Shqyrtimi i propozim-vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me sipërfaqe prej 11.000 m². Për këtë pikë ftoj drejtorin Afrim Oruçin!

Afrim Oruçi – Faleminderit kryesues, i nderuar Nënkryetar, të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni propozimin e Kryetarit të Komunës, për pëlqim për këmbim të pronës komunale me pronë të institucioneve shtetërore, që menaxhojnë, konkretisht me Agjencionin Pyjor të Kosovës, bëhet fjalë për një parcelë e cila gjendet në zonën kadastrale në Kaznik, parcela ka pas më shumë se 4 hektar e disa ari, ne po kërkojmë prej juve të na jepni pëlqim për këmbimin e kësaj sipërfaqe të tokës me 1 hektar e 10 ari d.m.th. me i marr Agjencionit Pyjor në zonën kadastrale te rruga e tranzitit 1 hektar e 10 ari, ndërsa me i dhënë Agjencionit Pyjor me zonë kadastrale në Kaznik 1 hektar e 10 ari. Qëllimi i saj është ju të jeni të informuar në mbledhjen e fundit të Kuvendit para 3 muajve, që kemi bërë një projekt ideor interesant prej disa të rinjve në komunë të Rahovecit dhe qëllimi është të përfundojmë këtë që ta bëjmë pronë komunale të komunës së Rahovecit e që projekti me marr hapa tjerë. Ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit, të votojnë propozim- vendimin për pëlqim për këmbim të pronës.

Kryesuesi- Faleminderit shumë drejtor, urdhëro zonja Bajraktari!

Florida Bajraktari - Faleminderit kryesues, ne e përkrahim këtë propozim-vendim për dhënien e pëlqimit të këmbimit të pronës komunale me institucionet qendrore, por kam dëshirë me dit se çka kam me u bë konkretisht këtu në këtë parcelë, pra çka do të punohet aty. Faleminderit!

Kryesuesi-Faleminderit shumë, tjetër dikush diçka? Atëherë konstatojmë se kalon për Kuvendin Komunal pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt e rendit të ditës.

Shqyrtimi i propozim-vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me sipërfaqe prej 25.099 m².

Afrim Oruçi - Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni dokumentacionin e propozuar për këmbim të pronës komunale, bëhet fjalë për zonë kadastrale të njëjtë, është parcela shumë e madhe në Rahovec është mbi 700 hektar, ne po kërkojmë prej të na jepni pëlqim që më këmbye këtë pronë, me ia marr Agjencionit Pyjor mbi 2 hektar e 50 ari e disa m², kjo është shumë afër Majës së Shkodranit d.m.th. diku 200 metra prej Majës së Shkodranit, në të dy anët e rrugës egzistuese ku po punohen punime për asfaltimin e rrugës, ne po duam me i marr Agjencionit që e ka nën menagjim, Agjencionit Pyjor 2 hektar e 50 ari e disa m² dhe të njëjtit Agjencion me i dhënë në Zonë Kadastrale në Kaznik, në sipërfaqe të njëjtë. Qëllimi, arsyetimi i këmbimit është që me mbrojtë këtë zonë, pasi komuna ka plane, projekte tjera që me ju bashkëngjijtë këtij kompleksi që me funksionalizua si zonë turistike, ftoj kuvendarët pas shqyrtimit të votojnë propozim -vendimin për këmbimin e pronës komunale. Ju faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit drejtor, po z. Fazliu!

Rasim Fazliu - Faleminderit kryesues, edhe kjo është lëndë e njëjtë sikur ajo tjetra, veçse ndryshojnë metrat katror. Jemi pro këmbimit të pronës komunale me pronën e Ekonomisë së Pyjeve sepse është në dobi tonën, na ofrohet prona, përfitojnë bizneset aty kushdo qoftë. Komuna konkretisht aty fiton, por meqenëse ky është një dokument edhe në dokumentin e parë edhe të dytin, është mirë si dokumente që është me cek ku gjendet kjo ngastër. Unë po e kuptoj se drejtori na tregoi se ku është, por ky është dokument dhe ky mbetet aty edhe të ceket ku është kjo konkretisht, se prona komunale po thotë se është Stara Kuqo pra Vakufë po quhet, por kjo tjetra pronë nuk e ka emërtimin se ku gjendet kështu që për mbledhje të Kuvendit është mirë me cek aty se kjo pronë e Ekonomisë së Pyjeve gjendet në këtë vende edhe bëhet këmbimi, kështu që unë propozoj të kaloj për Kuvend dhe atje sigurisht se marrim vendime të caktuara. Ju faleminderit!

Kryesuesi- Faleminderit shume z. Fazliu. Po urdhëroni z. Cena!

Fehmi Cena – Në fakt unë mendoj që kur i kemi pikat e tilla të rendit të ditës që kërkohet nga ne aprovimi i këmbimit të pronës komunale me këtyre të pyjeve, ne është mirë me u informue për qëllimin me saktë në qoftë se qeveria lokale, Komuna ka mendime, ka projekte të caktuara që mendon aty me i bo, që ta kemi një qartësi, në fund të fundit ne jo vetëm që jemi kuvendarë, jemi edhe qytetarë edhe thjesht duhet me ditë n'fakt çka planifikon, nëse mendon vetëm të bëhet këmbimi sa me pas në të ardhmen atë pjesë në rregull, por, nëse ata synojnë, kanë projekte për të lejuar që me u zhvillu aty, ne duhet me i ditë ato projekte për arsye se ne ndoshta edhe e kalojmë ose nuk e kalojmë, ai projekt mundet mos me na pëlqye edhe ne themi jo ky projekt nuk po na pëlqen. Edhe ne nuk lejomë që për këtë qëllim të bëhet këmbimi i pronës, nëse është projekti i pëlqyeshëm, atëherë do ta kemi qëndrimin më të qartë, kështu që unë po mendoj sikurse që ishte këtu te pika 2, po thotë qëllimi është interes publik, ai është qëllim madhor interes publik por më saktësisht, nëse për projekte, nëse flitet po e zëmë, drejtori tha se aty parashihet n'fakt një projekt që anash e kemi ndegjuar se çfarë do të jetë po ai nuk duhet me ngurrue, me na thënë se ne e kemi një kërkesë, faktikisht ankandi do të bëhet, por ne mendojmë që prioritet do ti japin një lloj projekti, i cili do të jetë kështu edhe ne e formojmë mendimin tonë, a është në rregull apo nuk është në rregull, ndoshta nuk pajtohemi me mendimin e qeveritarëve ose të ndonjë drejtori. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë z. Cena, po drejtori dëshiron ta bëjë një sqarim. Urdhëroni drejtor!

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar doktor, saktësisht për te Maja Shkodranit, ne po mundohemi që atë parcelë ta këmbejmë me pronë komunale që ta bëjmë pronë shtetërore të komunës, për shkak se ne jemi duke zhvilluar shume punime atje. Rruga po asfaltohet, që shumë shpejt ka me qenë e qasshme për biznese, për njerëz dhe për derisa ajo vazhdon me qenë e Agjencionit Pyjor, njerëzit prej neve marrin veç një pëlqim, edhe ne nuk vendosim çfarë biznesi edhe çka do të bëhet aty, s'mundemi t'a ruajmë, ne po mundohemi t'a zëmë hapin që të shkojnë gjithë ato prona përreth Majës Shkodranit, me i këmbye me i bë prona komunale edhe ne me vendos bashkë me juve, Kuvendi me vendos të ardhmen se çka don me u zhvillu aty d.m.th. ideja është me i marr Agjencionit, se Agjencioni mezi pret me i dhënë me qira, me marr pare edhe ata le të hapin çka të duan. Faleminderit!

Kryesuesi- Faleminderit shumë drejtor, pasi që nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatojmë që kalon edhe pika e katërt e rendit të ditës, pra kalon për Kuvend, kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës.

Shqyrtimi i propozim-buxhetit si dhe KAB-it për vitin 2020-2022, për këte pikë ftoj Drejtorin e Financave.

Afrim Limani - Përshëndetje edhe një herë! Dua të ju tregoj, kësaj here pasi që jeni në numër më të vogël, tu them që jam i lumtur, pasi që sot një vjet kam qenë në një gjendje krejtësisht tjetër, e këtë proces e kam monitoruar nga telefoni. Buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2020 në total është 14.735.821 euro, për dallim nga qarkorja e parë do të thotë, strukturat e kategorive ekonomike, në qarkoren e dytë ka ndryshuar buxheti kryesisht në pozicionin e pagave, që kemi një rritje prej 104.000 eurove. Tani zvogëlime në bazë të qarkores së parë, në mallra dhe shërbime një zvogëlim prej 51.446 euro, shërbimet komunale janë rritë në vlerë prej 25.000 euro edhe subvencionet janë rritë me vlerë 61.000 euro, do të thotë krejt këto subvencionet dhe shërbimet komunale janë rritë me kërkesën tonë që e kanë ndryshuar strukturën e buxhetit, kuptohet që në dëm të investimeve kapitale. Shërbimet komunale i kemi rritë prej 25.000 eurove sepse kemi investuar shumë në ndriçimin publik edhe realisht ato shpenzime duhet me i mbulua, subvencionet janë rritur diku prej 61.000 euro dhe kryesisht kemi menduar këto mjete me i orientua në bujqësi. Dokumentin KAB-i komunal apo Korniza Afatmesme e Shpenzimeve do të thotë si dokument na e kemi përgatitë edhe është e plotësuar dhe mund të ndodhë që në mbledhjen e Kuvendit do të ketë një ndryshim të vogël për shkak të pozicionit të pagave, ju e keni sqarimin aty sepse vazhdimisht po marrim edhe rekomandime nga Ministria e Financave dhe për atë mund të ndodhë që ndryshon sepse jemi duke i futur të dhënat në sistem..... do të thotë KAB-i si dokument është i kompletuar dhe janë të plotësuar ato tabelat të cilat kanë qenë të zbrazëta në mbledhjen e parë kur e kemi diskutuar qarkoren e parë buxhetore. Unë do të dal në atë pjesën tjetër edhe bashkërisht të analizojmë, bëjmë pyetje edhe diskutojmë, është KAB-i komunal pastaj është edhe pjesa e investimeve kapitale që është me vlerë prej 3.905.770 euro, do të thotë KABI-i si dokument ne raport me qarkoren e parë buxhetore që kemi përgatitë dhe është e plotësuar, ju mund ta shihni me radhë gradualisht, këtu nuk kam

shumë të diskutoj sepse e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e parë mirëpo ne e kemi plotësuar, kemi ndryshuar ato pjesë teknike, disa gabime teknike, nëse dikush ka ndonjë pyetje ne do te ndalemi edhe do diskutojmë, dokumenti është edhe i lekturuar. P.sh. kjo tabelë në qarkoren e parë buxhetore ka munguar, të dhënat e vitit 2020, e që tash është e kompletuar, për dallim të viteve tjera kësaj here nuk kemi huamarrje, do te thotë e shihni fushën e zbrazët në Shëndetësi dhe Arsim, në total buxheti ka dal sipas kategorive ekonomike, përqindjet sa është pjesëmarrja, këtu e kemi edhe strukturën gjinore nëpër të gjitha drejtoritë sa pjesëmarrje, e sa femra, të shprehura në përqindje kuptohet edhe numri, nëse ka ndonjë pyetje rreth KAB-it mund ta bëni, atëherë mund të kaloj te lista e investimeve kapitale që është ndoshta më e rëndësishme edhe që juve ju intereson më së shumti. Të nderuar anëtarë të KPF-së, kjo është një tabelarë e listës së projekteve kapitale ku në shtyllën e parë e kemi pjesën e grandit të financuar nga Ministria e Financave, shkalla e dytë është të hyrat vetanake që në total janë 760.000 ndërsa grandit është 3.145.770 euro dhe kjo në total e përbën buxhetin 3.905.770 euro ndërsa i kemi edhe projeksionet për vitin që është rregull, që duhet me i paraqit, projeksionin për vitin 2021, 2022 edhe totali i buxhetit për vitin 2020, 2021 dhe 2022 edhe kjo disa rreshte i kemi identifikuar edhe me ngjyra, për me mujtë me i pas më qartë ju, ngjyra vjollcë e qeltë tregon programin apo drejtorinë ne total sa është pjesëmarrja e saj, pastaj kemi ngjyrën e kaftë të qeltë që i kam identifikuar projektet të cilat si projekte egzistojnë, mirëpo janë vlera të pashkruara që disa prej tyre kemi menduar t'i mbulojmë me bartjen e mjeteve që kryhet gjatë muajit shkurt, pastaj ngjyra vjollcë e qeltë i kam identifikuar disa projekte me këtë ngjyrë, që janë kryesisht kërkesa dominante të cilat i kanë parashtruar qytetarët që i kemi dëgjuar bashkërisht në debatet buxhetore, që i kemi patur me ju, do të thotë me anëtarët e KPF-së dhe këto janë si kërkesë e parë: **Përmirësimi i kanalizimit në komunën e Rahovecit**, gati në çdo vendbanim ku jemi shkuar, ka qenë kjo kërkesë, pastaj, si kërkesë e dytë apo e para këto janë nja 5 apo 6 projekte në top listë si të kërkuara, pastaj është: **Meremetimi i rrugëve dhe trotuareve**, pastaj, **Ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit**, do të thotë rrugë në vazhdim, pastaj kemi **Ndriçimin publik dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues**, emërtohet si projekt ama ka pasur kërkesa edhe për ndriçim publik, pastaj kemi **Trajtimin e kanalizimit fekal** si projekt i ri, pastaj **Trajtimi i ujërave atmosferikë në qytet** si projekt i ri për shkak të vërshimeve të mëdha që ka pas qyteti i Rahovecit, atëherë ne kemi thirrur një ekip prej ingjinerëve, do të thotë jemi në fazën e parë të përgatitjes se një projekti ideor edhe ne e kemi futur ne listën e projekteve kapitale si projekt, besoj që do të thotë se ka shansa edhe në vitin 2020 të fillohet të implentohet, pastaj kemi **Zgjerimi i ndriqimit publik** dhe një kërkesë që në çdo vendbanim ka dominuar, pastaj kemi kanali i kullimit të tokave bujqësore në komunën e Rahovecit, **Ndërtimi dhe mirëmbajtje e rrugëve fushore** do të thotë këto janë 5 apo 6 kërkesa që siç e dini edhe ju anëtarët e KPF-së vazhdimisht janë kërkuar nga qytetarët në të gjitha vendbanimet. E fillojmë edhe një herë, Administrata i ka këto projekte që vlere e buxhetit në kuadër të Administratës bashkë me të hyrat vetanake 20.000 pastaj në Financa një kod bashkëfinancim e kemi 40.000, Shërbimet Publike është 980.000 euro, zjarrfikësit nuk ka, **Zyra Lokale e Komuniteteve** është një projekt prej 20.000 eurove, pastaj Bujqësi, Pylltari dhe Zhillim Rural është 1.16.000, në Zhvillim Ekonomik i kemi 60.000 euro kështu me radhë që të mos ju marr kohë, dhe për atë unë po mundohem me qenë komod, do të thotë në total buxheti i komunës së Rahovecit për investime kapitale është 3.905.000, ku lirisht mund t'ju them që në kuadër të këtyre projekteve janë të futura të gjitha kërkesat e qytetarëve që bashkëarisht i kemi ndëgjuar në vendbanimet e komunës sonë. Faleminderit!

Kryesuesi- Faleminderit drejtor, po z.Fazliu!

Rasim Fazliu- Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin që na dha sqarime rreth KAB-it edhe rreth projekteve të investimeve kapitale që do të bëhen për vitin 2020. Fillimisht ky është një dokument që është mirë mos të lëshohen gabime këtu, unë vetëm po i përmendi nja dy, e për të tjerat tani edhe të tjerët, po shkojmë në faqen e 9-të, në fillim të hyrat vetanake komunale kanë shënuar zvogëlim (rënie), me që jemi te gabimet po shkojmë në faqen 11-të, donatorët e jashtëm ndërkombëtarë që e kanë bërë, fjalia është e shkruar gabimisht „financimi nga donatorëve të jashtëm dhe të brendshëm“, e që duhet të jetë financimi prej donatorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Tani po kalojmë në përmbajtje të KAB-it, drejtor edhe këtu në KAB janë të sqaruara shumë gjëra, pse ka zvogëlime aty, pse ka rritje këtu etj. Por unë e kisha një pyetje që edhe pse e dimë që tash e prapa gjërat e gjykatave dhe gjërat në trafik planifikohen nga niveli qëndror e kemi të qartë atë, e për atë planifikimi i të hyrave vetanake d.m.th. ka rënie ose për mua është planifikim jo i

duhur, pra është i vogël planifikimi, pse shtrohet pyetja është i vogël? Sepse sipas meje, mendoj që komuna gjithmonë duhet me pas pretendime me i rritë të hyrat vetanake apo jo, edhe kemi arsye sepse kemi tatimin mbi tokat që do të filloj në vitin 2020 kështu sipas drejtorit që na ka thënë apo jo, pastaj si qeveri komunale duhet të kemi menduar ose të kishim menduar që u kryen dy vite po ashtu edhe ne qeverisjen e kaluar nuk kemi mundur me fut menaxhimin e mbeturinave nën kontrollin e komunës apo jo, që sigurisht do të kishte ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e të hyrave vetanake të komunës, siç po shihet edhe në këtë KAB nuk ka në këtë drejtim asgjë hiq edhe për atë është paraparë që të hyrat vetanake me mbetë ashtu statike qysh kanë qenë edhe viteve të kaluara prandaj po them këto janë dy arsye të fuqishme e që ndoshta ne duhet të punojmë në këtë drejtim edhe për menaxhimin të mbeturinave edhe tjera në mënyre që planifikimi i të hyrave vetanake me qenë ma i madh se sa është këtu i paraparë, këtu po shkojmë me radhë në faqen 11-të, kemi donatorë të jashtëm dhe të brendshëm që përmenda, financimi nuk është cekur asgjë vetëm pse është shkruar do të vazhdojmë të bashkëpunojmë por diçka konkrete nuk kemi më tutje. Unë do të ndalem më tepër te lista: planifikimi i investimeve kapitale për vitin 2020, 2021 dhe 2022, ne e dimë që mjetet buxhetore janë të kufizuara, janë ato që janë edhe brenda atyre duhet të veprojmë, jam i vetëdijshëm për atë mirëpo nuk e di sa këtu ju kemi përmbajtë disa kriterëve që janë, p.sh. janë kategoritë ekonomike edhe mos kemi bërë kapërcime prej një kategorie në kategorinë tjetër ekonomike në planifikimin e investimeve kapitale kështu që kisha kërkuar përgjigje prej drejtorit që a ju ka përmbajtur striktë kategorive ekonomike apo ka diku lëshime, shkelje në këtë drejtim pastaj një çështje në pikën paraprake e ngriti shoku i nderuar Dervish Qadraku edhe unë jam për atë që projektet që janë të përgjithësuara me u emërtuar do të ishte mirë me cek lokacionin saktë, ku është edhe për qytetarët do të ishte mirë, edhe unë mendoj që do ishte një praktikë e mirë sepse edhe qytetarët e komunës së Rahovecit do ta kenë të qartë se çka do të bëhet në fakt apo jo? Shembull të marrim rrugë fushore nuk mjafton të thuhet veç se kaq metra janë paraparë për mbushjen, meremetimin apo rregullimin e rrugëve fushore por është mirë të thuhet, do të rregullohet kjo rrugë e caktuar edhe ne e dimë që i kemi hequr këto prej rendit të ditës edhe tani vijnë rrugë tjera që presin me të drejtë qytetarët që ta din njëfarë rendi ku është njëfarë planifikimi pra mos të shkojmë me projekte të përgjithësuara por të jenë të detajuara, për më tepër unë do të kontribuoj në mbledhjen e Kuvendit Komunal, e pres përgjigje prej drejtorit rreth pyetjeve që i parashtrova sidomos rreth kategorive ekonomike. Faleminderit shumë, e pastaj sigurisht ne si grup do të dalim me siguri me një propozim pak më ndryshe për të dhënë idenë se si duhet të shkojmë më tutje. Ju faleminderit.

Kryesuesi - Faleminderit shumë z.Fazliu, tjetër dikush, urdhëro z.Cena!

Fehmi Cena - Faleminderit kryesues, natyrisht Korniza Afatmesme Buxhetore KAB-i është një pikë e rendit të ditës shumë me rëndësi, sepse ka të bëjë me pjesën e buxhetit për vitin 2020-2022, kërkon një analizë më të hollësishme dhe ne do ta japim kontributin tonë bashkë me kuvendarët tjerë më se shumti në mbledhjen e kuvendit por sot do të japim gjithashtu disa mendime dhe do të kërkojmë sqarime nga drejtori, natyrisht e falënderojmë drejtorin fillimisht për materialin që na ka servuar, për mua kështu është i qartë edhe në pjesën tekstuale edhe pjesën tabelare e qartë, në rregull, po filloj me pjesën tekstuale do të thotë këto prioritet kryesore që i ka cekur qeveria lokale në rregull është, kështu kanë qenë edhe herën e kaluar edhe sa i përket prioritetve ne pajtohemi do thotë është forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë, te Bujqësia ajo çka shoh një ndryshim është për serra që do të jepen në sipërfaqe më të madhe që deri tash kanë qenë 3 ari dhe 5 ari tash do të ketë 7 ari edhe 10 ari, natyrisht ne përkrahim serrat sepse komuna jonë është bujqësore dhe përfitojnë bujqit, dihet se komuna jonë ka shumë familjarë, shumë bujqësi, ekonomitë familjare shumica e tyre varen nga bujqësia, punësimet mendojmë se gjenerojnë aty, vetëm si kuvendarë urojmë që këto serra kur ndahen, të ndahen në mënyrë të drejtë, të iu jepet njerëzve mundësia e barabartë, jo të shkojë në bazë të kualifikimeve të tjera. Te sektori i vreshtarisë, ceket sektori i vreshtarisë inventar për trajtim të rrushit, pra ajo me çka do të ndihmoj komuna pas vjeljes edhe diku tjetër mendoj përmendet pak më shumë do të thotë etiketohen pak më tepër këto podrumet që përbejnë përpunimin e rrushit që bëjnë verë e raki, në fakt mendoj se dhe ashtu përfitojnë edhe nga grandet qëndrore edhe nga donacionet, edhe tash së fundi ju kemi hequr edhe taksën atyre, mendoj se komuna duhet me tepër të përqendrohet me ju ndihmuar prodhuesve direkt të rrushit sepse ata kam një përshtypje se janë më të shkelur edhe kur përmendëm me lartë tek perimekultura dhe pemëtari ndoshta është mirë të shkruhet edhe vreshtari ose nëse përfshihet edhe

vreshtaria ne kuadër te pemëtarisë është diçka tjetër por mendoj që vreshtaria megjithatë duhet ta ketë terminin e vet edhe vreshtarët të subvencionohen me kultivatorë të vegjël, spërkatëse që ceket këtu të precizohet. Te shtylla tjetër: Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, Planifikimi Urban dhe Shërbimet Publike komunale janë cekur gjithashtu të gjitha elementet, unë i kisha dhënë një theks të veçantë kolektori dhe impianti për trajtimin e ujërave të zeza, këtu duhet te shikoj komuna që të investojë në kolektorë, duhet të filloj me përpunimin e ujërave të zeza sepse të gjitha ujërat natyrore janë bërë kanalizime, pajtohem me zgjerimin e rrjetit të kanalizimit sepse kemi nevojë në shumë vendbanime duke përfshirë edhe në disa pjesë të qytetit d.m.th. këto janë prioritet i shkallës së lartë kisha me thënë. Gjithashtu edhe menaxhimi i integruar i mbeturinave dhe riciklimi i tyre edhe ajo duhet të jepet në prioritet, duhet të punohet në këtë drejtim, të fillohet me këtë sepse ende nuk ka filluar asgjë me u bë, përmirësimi dhe zgjerimi i ujit të pijshëm, ky është prioritet mbi prioritetet. Këtu duhet të investoj komuna aty ku i takon natyrisht sepse uji i pijshëm është jetik dhe e dimë se disa vendbanime e dimë se nuk e kanë ujin e pijshëm higjenik është fjala që ende përdorin ujin e puseve dhe ajo nuk është e shëndetshme dhe rrezikon shëndetësinë publike, do të thotë aty duhet të investohet më shumë. Te pjesa tabelare është tabela, planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2019-2022, kjo te titulli me ka rënë në sy planifikimi i të hyrave vetanake, e që në fakt tabela nuk ka të bëjë me të hyra vetanake. Drejtor, ndoshta ka nevojë të përmirësohet, kisha thënë planifikimi i të hyrave komunale sepse të hyrat vetanake dihet i kemi pak më poshtë, këtu janë të prezentuara të gjitha të hyrat edhe vetanake edhe ato nga grandit, edhe unë e ndaj mendimin që planifikimi për vitin 2020 po shihet se ka një rënie në krahasim me vitin që jemi 2019, jepet sqarimi më lartë, do të thotë për -1.0-2% planifikimi është më i vogël, për shkak se nga viti 2020 të hyrat nga gjobat nga gjykatat dhe trafik do të prezantohen në nivelin qëndror, mirëpo mendoj megjithatë duhet të ketë rritje të buxhetit e jo rënie edhe pse është kjo klauzole për arsye se është tatimi në pronë që komuna duhet të përkujdeset me pas rritje për çdo vit, pagesat janë më të rregullta pastaj është tatimi në tokë gjithashtu që do të jetë një shtesë e pagesës nga qytetarët e taksës dhe nuk e shoh të arsyeshme që për vitin 2020 planifikimi të jetë më i vogël i buxhetit komunal në krahasim me 2019, përkundrazi mendoj që duhet të ketë rritje. Te faqja e 10 disa sqarime kisha kërkuar, tek Urbanizmi po shohim një rënie të planifikimit të të hyrave, për vitin 2019 ka qenë 103.000 e tash 22.450 euro, është një ndryshim shumë i madh po e zëmë taksa komunale për leje ndërtimi nga 350 është zvogëluar në 200 euro, kërkoj një sqarime pse po ndodhë kjo, a nuk ka taksa komunale, spo kërkon askush leje ndërtimi, tash aq shumë kanë rënë këto kërkesa për leje ndërtimi në komunën tonë apo mos janë gabime të ndryshme ose bartje diku tjetër, të njëjtat drejtori taksa për legalizim të objekteve nga 38.000 e kemi zero, shfrytëzimi i pronës publike nga 24.000 e kemi zero, kjo e zvogëlon shumë buxhetin, diku kemi duplikime po zëmë tek e njëjta drejtori, Urbanizmi, shfrytëzimi i pronës publike kemi edhe në Shërbime publike, shfrytëzimi i pronës publike, këtu te Shërbimet Publike, shfrytëzimi i pronës publike është paraparë 12.000 të hyra me pas për këtë vit, lartë është zero, pse ky duplikim, edhe diku tjetër e kam parë diçka në dy drejtori i njëjti term përdoret. Tek Inspekcioni kemi gjithashtu më pak planifikohen të hyrat, një sqarim kërkoj te gjobat nga Inspektorati, po thotë 1.000 euro për vitin 2020 planifikohet nga Inspektorati nga gjobat të ketë komuna të hyrat, nuk e di këto Barnatoret humane, ne kur rrijmë me ta ata thonë se kanë pas dënim me një rast 1.000 euro, 1.200 euro prej Inspektoratit vetëm me një rast, ndërsa këtu gjithë vitin po thuhet se do të ketë të hyrat nga gjobat 1.000 euro Ndoshta po e kërkoj sqarimin po e zëmë, a hynë gjobat e tonë në kuadër të komunës tonë apo ndoshta mos janë në nivele qëndror. Te Shëndetësia participimi nga Shëndetësia, vitin e kaluar ka qenë 50.000 e tash është 40.000, në rregull edhe unë pajtohem me atë kur është planifikuar 50.000 ka qenë një planifikim ambicioz mirëpo ato që kërkoj unë edhe në Shëndetësi le të ndahen, participimet, le të veçohen, le të specifikohen nga participimi, nga certifikatat mjekësore se ka disa të hyrat, le të dimë herën tjetër, sa ka participim nga puna e doktorëve, sa kemi participim nga certifikatat do të thotë bashkëpagesat, mendoj që më mirë do të ishte ajo të ndysohet tabela në mënyrë që ti kemi gjërat më të qarta. Faqe 12, aty thuhet një klauzole se tek kategoria ekonomike e pagave, komuna s'ka drejtë me pas ndërhyrje, rrregull ajo është rrregullore nga niveli qëndror edhe pse ne shohim se kemi një rritje në paga për 1.208.000 e diçka, kjo rrregull është se ndoshta komuna ska të drejtë me ndërhy mirëpo unë pak megjithatë shqetësohem se për paga ndoshta po bëhet shpenzim shumë i madh, nëse ai buxhet mund të shfrytëzohet për diçka tjetër, në qoftë se është fjala për ngritje të pagesë është diçka tjetër, nëse është punësimi është shtuar punësimi n'rregull, por

shtohet pyetja a ka qenë ai punësim racional, a po punësohen njerzit vertetë me krye punë apo paguhen për shërbime apo po punësohen vetëm sa me marr rrogë atëherë buxheti po shkon në menyrë të njëanshme, po shifet poshtë se po rritet për do vite përqindja e buxhetit total për paga, kjo është qeshtja e tash mallrat e shërbimet kemi rritje në krahasim me vitin e kaluar për 80 000 në mallra dhe shërbime, tjera shpenzime komunale 25 000 e tash me mujtë me i kursye këto pare se lehtë është me thanë se ne po i qesim edhe kaq pare po i shpenzojmë mirpo ne jemi më të interesuar më tepër me u shfrytëzue paraja në menyre racionale nëse vertetë është e domosdoshme por nëse jo pikërisht tek mallrat dhe shërbimet edhe shpenzimet komunale duhet të shiqohet me u kursye ma pak me u shpenzue edhe kjo pjesë e buxhetit me kalue në investime kapitale e që në investime kapitale përkundrazi kemi ma pak këtë vitë ndoshta ka qenë edhe granti më pak mirpo duhet të shiqohet të mirret nga këto pozicione që mund të shfrytëzohet një pjesë dhe të kalojë në pjesën e kapitaleve që na dëshirojmë sepse ajo është në interes të qytetatarve më tepër, këto janë vërejtjet tona serioze që mendoj që do ti paraqesim edhe në mbledhjen e ardhshme edhe ti kenë parasysh. Në faqe 13 kjo forma tabelare shiqone ka disa gabime aty drejtor, është një gabim teknik, shpenzimet komunale i kenë paraqit 1.9% poshtë nersa naltë i kemi subvencionet 1.9% pastaj subvencionet dhe transferet në pjesën tekstuale nuk e kemi pra mungon, pra subvencionet dhe transferet poshtë janë 2.11 % në pjesën tekstuale fare nuk egzistojnë e në fakt subvencionet janë 1.9%. Tek politikat e reja faqe 11 ajo çka me ka ra në sy është hequr klauzola aplikimi i ligjit për gradim, për paga për shërbimin civil, a është hequr kjo nga qarkorja buxhetore do të thotë për gradimet e ndryshme që do të bëhen, i është ndaluar komunës me bo gradime. Në faqen 16 përsëri tek shëndetësia, po shoh që ka rritje të buxhetit goxha shumë në rregull është që ka rritje të buxhetit por përsëri po bien në sy, një shumë e madhe, një diskrepancë e madhe në paga dhe mëditje, një sqarim edhe këtu do të thotë njësoj pra në këtë tabelë në faqe 16, tek zyra e Kryetarit kërkoj një sqarim tek subvencionet 90.000 euro, në vitin e kaluar kanë qenë 86.650 euro, ne kemi pas edhe atëherë vërejtje neve nuk ka duk se shumë është, tash është rritë përsëri një sqarim për çka se ma tepër zyra e kryetarit ka buxhete për subvencione se sa p.sh. bujqësia që i ka 60 000 ndërsa zyra e kryetarit i ka 90 000 euro, ndërsa për këtë pjesën kapitale edhe unë pajtohem me atë që në mbledhjen e ardhshme le të mundohen drejtoret me bo prezentimin me specifikime më të sakta rreth projekteve shpenzimeve jo në mënyrë të përgjithësuar, në rregull disa gjëra e kuptojmë se mund të jenë të përgjithësuar mirëpo ata kur e bëjnë planin vjetor, unë besoj se duhet me dit në shumicën e projekteve që synojnë për vitin e ardhshëm me krye duhet me ditë me emër dhe mbiemër shumicën nuk po them 100% por shumicën po dhe për atë janë edhe drejtoritë edhe ne me pas gjëra të qarta se konkretisht se për çka do të shpenzohen sipas kodeve ato para. Faleminderit!

Kryesuesi- Faleminderit shumë z.Cena, po urdhëroni znj. Lushi!

Fahrie Lushi – Faleminderit kryesues, unë do të ndërlihem vetëm me dy çështje, të cilat mbeten ndoshta pa u përmend deri më tani sepse parafolësit e mi thanë të gjitha ato që i takojnë kornizës afatmesme buxhetore mirëpo unë do të ndalem vetëm tek arsimi më tepër edhe tek rini dhe kulturë sepse janë përmendur disa pika që më të vërtetë e bëjnë kaq të arsyeshëm këtë kornizë mirëpo edhe nga viti i kaluar ne kemi parë shumicën e këtyre që janë këtu e që janë bartur drejtpërdrejtë këtu mirëpo unë habitem edhe me drejtorin e DKA-së sepse asnjëherë nuk gjen ndonjë pretekst ose arsye që të jetë prezent këtu kur janë parasysh kornizat afatmesme buxhetore e që është edhe një planifikim i veçantë edhe për arsimin ndoshta nuk janë çështje që e bëjnë shumë të rëndësishëm për drejtorin mirëpo mirë do të ishte me qenë prezentë këtu sepse janë tema që janë përmendur se pika që janë përmendur edhe në vitin e kaluar dhe ne jemi dëshmitarë dhe ju referohemi menjëherë dëgjimeve buxhetore të cilat shumicën prej tyre i kemi realizuar nëpër shkollat tona të komunës tonë dhe kemi parë se në çfarë gjendje ndodhen ato objekte, ndërsa kemi pasur arsyetim në fshatin Xërxë konkretisht që s'mundemi t'i mbajmë dëgjimet buxhetore në shkollë, është dashur me i mbajtë në sallë të kulturës edhe pse kemi qenë pak persona në numër sepse kanë thënë se nuk hapen as dritaret e saja shkollë andaj të mos të bëjmë thjesht vetëm pika që të bëjmë kornizën të duket apo të lexohet edhe dëgjohet thjeshtë ta ketë interpretimin e plotësuar përderisa mungojnë në shkollat tona gjërat elementare. Unë shoh këtu investime, mjete konkretizimi laborator, teknologji informative po ashtu edhe furnizimi i bibliotekave shkolllore me libra ndërsa unë skam dëgjuar në ndonjë shkollë që kanë hapësire të tillë të një biblioteke komode e cila ju plotëson kushtet edhe të leximit sepse në klasat e nxënësve tanë kam parë që mungojnë edhe karriget edhe ato që janë nuk janë të nivelit të duhur që nxënësit tanë të komunës tonë nuk përjetojnë

komoditetin e të qenit nxënës sepse bankën dhe karrigen nuk e kanë ashtu si duhet po ashtu janë edhe angazhimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike në shkollë, e ka përmend drejtori në secilën informatë në këto dy vitet që unë jam në ansamble që do të bëhet shumë shpejt, a ka mundësi të kemi një saktësim që të kemi një detaj, në veçanti të një shkolle se ku ekziston ai psikolog? Ose ku ekziston ai pedagog? A është angazhuar sepse e dimë që ndoshta janë organizime edhe në nivel vendi, jemi mësuar me këto arsye që ndoshta e bëjnë edhe të pavlefshme informatën ndonjëherë, por, megjithatë unë kërkoj specifika të veçanta ose specifitime nga ana e drejtorit që të paktën ti përmend disa nga këto prioritetet që i ka të vendosura këtu DKA –ja, që është bërë në këtë shkollë ose në atë shkollë, për dallim nga shkolla e fshatit Kramovik dhe Malësi e Vogël të cilët janë të reja dhe e dimë se ato objekte të reja duhet të jenë në atë mënyrë komode, sepse janë ndërtuar shumë shpejtë mirëpo ato shkolla të cilat i përmendi gjithëherë se do i rinovojmë, do i meremetojmë dyert e dritaret, unë skam parë madje as në Gjimnazin “Xhelal Hajda- Toni” në Rahovec, që të jetë një gjimnaz i mirëfilltë, aty madje as dritat skanë pas mundësi me i lëshu, kështu që kërkoj disa sqarime dhe specifika që drejtori i Arsimit ti përmend se ku e ka bërë atë dhe ku i ka bërë këtë. Pastaj edhe tek Rinia edhe Kultura janë përmendur ndërtimi i Teatrit të Qytetit, ku do ta bëjë atë? Janë përmendur edhe shumë tjera, pasurimi i Bibliotekave sepse kjo më intereson shumë edhe besoj që ndoshta nuk kemi nxënës kreativ që e duan edhe aq shumë leximin por ne si institucione e kemi për obligim të ju ofrojmë atë komoditet dhe që nxënësit tonë të kenë edhe librat e mjaftueshëm po ashtu edhe pasurimin me tituj të rinjë sepse ato janë libra ose lektyra të cilat i kanë lexuar më kaherë dhe tash për tash u duhen tituj të rinjë, po ashtu pikë së pari duhet tu ndërtojmë komoditetin, të ofrojmë mënyrën se si ata të ndihen komod, të shkojnë të shohin bibliotekën, të vizitojnë e madje të ulen edhe të lexojnë mirëpo me këtë komoditet ose me këtë mënyrë se si i kanë ata shkollat e bibliotekat nuk i tërheqin vëmendjen as ti shohin në sy e lëre më të shkojnë të lexojnë. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë zj.Lushi, tjetër dikush, po urdhëroni z.Qadraku!

Dervish Qadraku - Faleminderit kryesues, se di ndoshta po ndërlihem edhe pse nuk ishte qëllimi por po ndërlihem edhe me diskutimin e parafolësës sepse nuk është mirë që nuk janë drejtorët këtu sot sepse është edhe planifikimi i investimeve kapitale sepse na është dashtë me i hjek apo me i qitë diçka edhe në bashkëpunim me ta, të rregullohet edhe një listë të re përafërsisht edhe e dyta shkollat e reja në Malësi të Vogël, tha zonja më përpara, por ti të shkosh në shkollën e Malësisë së Vogël, me pa dritaret që një numër i madh i tyre ndoshta më tepër se gjysma e tyre nuk mbyllen mirë edhe e dyta tash llogarite ajo pjesa që është edhe krejt është nga jugu d.m.th. gjithë ditën nxënësit i ekspozohen rrezatimit pra mu rrezit pa perde të cilat mundeni me marr me mend qysh mundet të rrijë fëmija përballë dritareve dhe duke ju ekspozuar diellit. Por ne jse kjo është çështje që ne do të flasim tjera herë. Sa i takon planifikimit të investimeve kapitale unë të them të vërteten, kam shume vërejtje por kam edhe propozime por s’kam mundur me i sistemua, prandaj nuk po dua të flas sot konkretisht për këtë planifikim, sepse siç tha edhe parafolësi m ‘duket Rasimi, ne do të konsultohemi dhe do të dalim, po flasë për grupin tim të Vetëvendosjes, me një projekt të ri sa i takon planifikimit të investimeve kapitale por unë kam disa vërejtje këtu te planifikimi i të hyrave edhe në faqe 9, po fillojmë, kam një përshtypje se nuk ka qenë shumë serioze planifikimi, sepse ka disa dallime të mëdha në mes të viteve d.m.th. planifikimet që janë bërë edhe ka shifra që janë bërë, që mua nuk ma mbushin mendjen që munden me ndodhë ose e kundërta. Kisha pas dëshirë që me më përcjell drejtori, nëse mundemi të bashkëpunojmë sa i takon përgjigjeve që më duhet me i pas, e kemi faqen 9 tek Administrata, njërën prej atyre e kemi taksat tjera administrative për vitin 2019, kanë qenë 3000 euro kurse për vitin 2022 do të jenë 19.000 euro, me çka bazohet kjo rritje kaq e madhe që bëhet duke filluar pastaj edhe tek të tjerat ku kemi p.sh. te Shërbimet Publike të hyrat nga shitja e mbeturinave që unë s’po e kuptoj e që janë 140.000 euro për vitin 2019, ndërsa për vitin 2022 do të jenë 47.400 euro, ky dallim po më bën përshtypje shumë ose kemi te Bujqësia, taksat tjera administrative kemi 1.200, ndërsa në vitin 2022 do të jenë 9.000 euro, në çka bazohemi? Thjesht pastaj kemi te participimet në Bujqësi, në vitin 2019 kemi 8.500, kurse në vitin 2022 kemi 52.500 euro. Participimi për arsim jo formal është 15.000 euro sot, ndërsa do të bëhet 300 euro për vitin 2022 d.m.th. janë këto disa prej vërejtjeve të mia për të cilat unë nuk pajtohem që është bërë planifikimi ose të më jepet arsyetimi pse ka ndodhë kjo kështu, kaq pra, faleminderit!

Kryesuesi- Faleminderit shumë z. Qadraku, atëherë me që u ngritën shumë diskutime dhe kërkesa për sqarime, nëse drejtori ka mundur me marr sqarime për të gjitha, urdhëro drejtor!

Afrim Limani - Gati të gjithë anëtarët e KPF-së, e parashtruat një pyetje të përbashkët, do të thotë te planifikimi i të hyrave ose planifikimi më i vogël, të gjithë pa përjashtim kështu që përgjigja ime e para është te planifikimi, siç e dini edhe ju limitet, tavanet e planifikimit të të hyrave vetanake do të thotë i cakton Ministria e Financave, ajo na cakton një limit, ju kaq duhet ti bëni të hyrat vetanake edhe kjo neve na ka shkaktuar shumë problem, do të thotë këtë vit me bë planifikimin e të hyrave vetanake për vitin 2020, pse doktor që the më herët, të hyrat vetanake është term nga Ligji i Financave Publike dhe përgjegjësi, nuk mundem me i emërtuar si të hyra komunale, ne mundemi me thënë, por kjo është term edhe për atë duhet të shkruhet THV aty, na ka shkaktuar problem, pse problem, e potencuat edhe ju gjobat e gjykatave dhe trafikut me një udhëzim administrativ shkon në planifikime të Ministrisë së Punëve Brendshme, dhe për atë ne e kemi një limit dhe jemi detyruar ta bëjmë kështu, zbritë atë, zbritë këtë, edhe këtë zbritje e kemi bërë, këto dallime gjithmonë në raport me rekomandime të auditorit që ka qenë vitin e kaluar, edhe i kemi korrigjuar disa kode që vazhdimisht ka pas planifikim edhe nuk janë realizuar d.m.th. ka pas në kuadër të një kodit në fakt është inkasuar një e hyre tjetër. Tash po dua të marr një shembull që doktori e tha p.sh. taksa komunale për leje ndërtimi 350 ka qenë e planifikuar dhe ne e kemi bërë 200 euro, pse e kemi bërë këtë shumë 200 euro sepse kjo vazhdimisht ka figuruar kështu, e të hyrat nga lejet e ndërtimit, është në kodin tjetër te inspektimi dhe respektimi i planit urbanistik, këto janë lejet ndërtimore edhe emërtohet kështu do të thotë këtu i kemi planifikuar 17.000, e që realisht ndoshta ne kemi me shku më ultë se sa realja që është ama më nuk ka me figurua leja ndërtimi planifikim 350 e realizo 200, pra 200 euro kemi me i bë, është një lloj kërkesë që paguhet 1 euro apo 5 euro, nuk e di edhe për atë e kemi planifikuar këtë do të thotë e mora veç një shembull, tjetër tatimi në tokë edhe unë vazhdimisht e kam potencuar këtu se asnjëherë duke e ditur që nuk është definitive akoma s'ka një ligj, pra një udhëzim edhe se kam diskutuar çështjen tatimin në tokë me frikën, se mund të ndodhtë edhe sivjet nuk bëhet ndoshta edhe bohet mirëpo një muajve e kemi pas një seminar kështu gojari, na kanë thënë se edhe sivjet, pra vitin 2020, tatimi në tokë nuk do të aplikohet, pse do të thotë Ministria e Bujqësisë, akoma nuk është e gatshme, me i përgatite dokumentacionet e nevojshëm që ka kërkuar, Departamenti i Tatimit në Pronë, mësuesi e bëri edhe një pyetje të interesante për mua, po ashtu edhe doktori, në raport kategoria e mallrave dhe shërbimeve, është rritë këtë vite në krahasim me vitin e kaluar, edhe pse është rritë dhe a do të eliminohen keq klasifikimet në raport me auditorin, do të thotë te kategoritë ekonomike paga, mallra dhe shërbime, investime kapitale këto i cakton Ministria e Financave, limitet, tavanet edhe ne duhet me vepruar në kuadër të atyre limiteve, tash mallrat dhe shërbimet në çdo institucion, në çdo komunë të Republikës së Kosovës, janë rritë kategoria e mallrave dhe shërbimeve, pse në raport me auditorin çdo organizatë buxhetore po del keq edhe për me ju ikë keq klasifikimeve, atëherë kanë shkruar me zvogëlime të investimeve kapitale edhe i kanë rritë mallrat dhe shërbimet, që p.sh. unë dua të përmend një rast rrënim i objekteve ka qenë investim kapital do të thotë në vitin 2019 ndërsa në vitin 2020, duke e ditur që u rritë buxheti i komunës sonë, diku përafërsisht, 90.000 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, atëherë këtë projekt e kam bartur të mbulojmë mallrat dhe shërbimet edhe i ikim keq klasifikimit, se në raport me auditorin, e ka një limit të caktuar, që e kam potencuar edhe më herët, që nëse e kalon atë diku përafërsisht 140.000 euro, atëherë automatikisht pasqyrat financiare do të marrin opinion negativ.

Rasim Fazliu- I nderuar drejtor, unë nuk kam pyetur vetëm për mallra dhe shërbime, unë kam thënë planifikimi investimeve kapitale që u bë përgjithësisht krejt këto projekte, këto që janë a kanë hyrë në kategoritë e veta secila, pyetja është, mos janë përzier sikur vitin e kaluar, e dini që kemi pasur problemin.

Afrim Limani - Konsideroj mësues se je i vonuar mirëpo nuk e përjashtoj atë se edhe ti mundesh me dhanë kontributin tuaj, me më sugjeruar, me më dhënë kritika, me më dhënë vërejtje, por unë e kuptova këtë si shumë pyetje me vend, besoj që më komuna e Rahovecit nuk do të ketë keq klasifikimin, si fenomen nuk do të ketë, dhe nuk besoj që do ta rritë atë limitin e keq për me dal pasqyrat financiare, do të thotë me opinion negativ sepse krejt këto i kemi planifikuar në kuadër të mallrave dhe shërbimeve, unë vetëm e thash një projekt. Edhe një pyetje tjetër në kuadër të një projekti të emërtohet, të dihet ku e marr si sugjerim tëndin edhe i kemi parasysh këto. Doktori i bëri disa pyetje, besoj që ju kam përgjigjur disa, por me doktorin e kisha

Kryesuesi- Faleminderit shumë z. Qadraku, atëherë me që u ngritën shumë diskutime dhe kërkesa për sqarime, nëse drejtori ka mundur me marr sqarime për të gjitha, urdhëro drejtor!

Afrim Limani - Gati të gjithë anëtarët e KPF-së, e parashtruat një pyetje të përbashkët, do të thotë te planifikimi i të hyrave ose planifikimi më i vogël, të gjithë pa përjashtim kështu që përgjigja ime e para është te planifikimi, siç e dini edhe ju limitet, tavanet e planifikimit të të hyrave vetanake do të thotë i cakton Ministria e Financave, ajo na cakton një limit, ju kaq duhet ti bëni të hyrat vetanake edhe kjo neve na ka shkaktuar shumë problem, do të thotë këtë vit me bë planifikimin e të hyrave vetanake për vitin 2020, pse doktor që the më herët, të hyrat vetanake është term nga Ligji i Financave Publike dhe përgjegjësi, nuk mundem me i emërtuar si të hyra komunale, ne mundemi me thënë, por kjo është term edhe për atë duhet të shkruhet THV aty, na ka shkaktuar problem, pse problem, e potencuat edhe ju gjobat e gjykatave dhe trafikut me një udhëzim administrativ shkon në planifikime të Ministrisë së Punëve Brendshme, dhe për atë ne e kemi një limit dhe jemi detyruar ta bëjmë kështu, zbritë atë, zbritë këtë, edhe këtë zbritje e kemi bërë, këto dallime gjithmonë në raport me rekomandime të auditorit që ka qenë vitin e kaluar, edhe i kemi korrigjuar disa kode që vazhdimisht ka pas planifikim edhe nuk janë realizuar d.m.th. ka pas në kuadër të një kodi në fakt është inkasuar një e hyre tjetër. Tash po dua të marr një shembull që doktori e tha p.sh. taksa komunale për leje ndërtimi 350 ka qenë e planifikuar dhe ne e kemi bërë 200 euro, pse e kemi bërë këtë shumë 200 euro sepse kjo vazhdimisht ka figuruar kështu, e të hyrat nga lejet e ndërtimit, është në kodin tjetër te inspektimi dhe respektimi i planit urbanistik, këto janë lejet ndërtimore edhe emërtohet kështu do të thotë këtu i kemi planifikuar 17.000, e që realisht ndoshta ne kemi me shku më ultë se sa realja që është ama më nuk ka me figurua leja ndërtimi planifikim 350 e realizo 200, pra 200 euro kemi me i bë, është një lloj kërkesë që paguhet 1 euro apo 5 euro, nuk e di edhe për atë e kemi planifikuar këtë do të thotë e mora veç një shembull, tjetër tatimi në tokë edhe unë vazhdimisht e kam potencuar këtu se asnjëherë duke e ditur që nuk është definitive akoma s'ka një ligj, pra një udhëzim edhe se kam diskutuar çështjen tatimin në tokë me frikën, se mund të ndodhtë edhe sivjet nuk bëhet ndoshta edhe bohet mirëpo një muajve e kemi pas një seminar kështu gojarisht, na kanë thënë se edhe sivjet, pra vitin 2020, tatimi në tokë nuk do të aplikohet, pse do të thotë Ministria e Bujqësisë, akoma nuk është e gatshme, me i përgatite dokumentacionet e nevojshëm që ka kërkuar, Departamenti i Tatimit në Pronë, mësuesi e bëri edhe një pyetje të interesante për mua, po ashtu edhe doktori, në raport kategoria e mallrave dhe shërbimeve, është rritë këtë vite në krahasim me vitin e kaluar, edhe pse është rritë dhe a do të eliminohen keq klasifikimet në raport me auditorin, do të thotë te kategoritë ekonomike paga, mallra dhe shërbime, investime kapitale këto i cakton Ministria e Financave, limitet, tavanet edhe ne duhet me vepruar në kuadër të atyre limiteve, tash mallrat dhe shërbimet në çdo institucion, në çdo komunë të Republikës së Kosovës, janë rritë kategoria e mallrave dhe shërbimeve, pse në raport me auditorin çdo organizatë buxhetore po del keq edhe për me ju ikë keq klasifikimeve, atëherë kanë shkuar me zvogëlime të investimeve kapitale edhe i kanë rritë mallrat dhe shërbimet, që p.sh. unë dua të përmend një rast rrënim i objekteve ka qenë investim kapital do të thotë në vitin 2019 ndërsa në vitin 2020, duke e ditur që u rritë buxheti i komunës sonë, diku përafërsisht, 90.000 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, atëherë këtë projekt e kam bartur të mbulojmë mallrat dhe shërbimet edhe i ikim keq klasifikimit, se në raport me auditorin, e ka një limit të caktuar, që e kam potencuar edhe më herët, që nëse e kalon atë diku përafërsisht 140.000 euro, atëherë automatikisht pasqyrat financiare do të marrin opinion negativ.

Rasim Fazliu- I nderuar drejtor, unë nuk kam pyetur vetëm për mallra dhe shërbime, unë kam thënë planifikimi investimeve kapitale që u bë përgjithësisht krejt këto projekte, këto që janë a kanë hyrë në kategoritë e veta secila, pyetja është, mos janë përzier sikur vitin e kaluar, e dini që kemi pasur problemin.

Afrim Limani - Konsideroj mësues se je i vonë mirëpo nuk e përjashtoj atë se edhe ti mundesh me dhanë kontributin tuaj, me më sugjeruar, me më dhënë kritika, me më dhënë vërejtje, por unë e kuptova këtë si shumë pyetje me vend, besoj që më komuna e Rahovecit nuk do të ketë keq klasifikimin, si fenomen nuk do të ketë, dhe nuk besoj që do ta rritë atë limitin e keq për me dal pasqyrat financiare, do të thotë me opinion negativ sepse krejt këto i kemi planifikuar në kuadër të mallrave dhe shërbimeve, unë vetëm e thash një projekt. Edhe një pyetje tjetër në kuadër të një projekti të emërtohet, të dihet ku e marr si sugjerim tëndin edhe i kemi parasysh këto. Doktori i bëri disa pyetje, besoj që ju kam përgjigjur disa, por me doktorin e kisha

bërë edhe kështu interaktiv se po më duket se nuk kam mundur kështu t'i shkruaj kështu të gjitha s'di ka bërë 10 apo 15 pyetje, i ka bërë, do të thotë ato vërejtje që i ke bërë doktor rreth KAB-it, i kemi evidentuar po ashtu edhe drejtori i Bujqësisë i ka evidentuar, besoj që për Kuvend do të kemi parasysh edhe do t'i fusim në dokument. Te planifikimi i të hyrave vetanake, besoj që ta dhashë përgjigjen edhe një shembull e mora pikërisht që ti e ke pyetjen, do të thotë taksa për leje ndërtimi njëjte është edhe te gjrobat nga Inspektorati më duket edhe këtë pyetje e bërë, do të thotë në gjrobat nga Inspektorati është një taksë e re e cila do të thotë ka dalë me një Udhëzim Administrativ në vitin 2019, mirëpo na i kemi planifikuar për afërsisht 1.000 euro këtu, janë gjoba që drejtpërdrejtë u jepen qytetarëve ndërsa lënda që shkon në gjykatë pra procedura e gjykatës, ato evidentohen si gjoba të gjykatës, edhe tash ku është përvoja e parë hera e parë edhe për afërsisht ne e caktuam një shumë pra një limit për mos me ditë se çka do të bëhet që thash edhe kufirin e kemi pas të ultë të hyrave edhe kështu. Ka edhe pyetje se pse janë rritë pagat, unë në KAB është sqarim aty të një faqe sepse në raport me qarkoren e parë edhe tash është rritë kategoria e pagave mirëpo realisht, ne sa do të kemi shpenzime janë më të mëdha sa do të jetë limiti në kuadër të kësaj qarkore, realisht ndoshta edhe më tepër diku mbi një milion do të thotë me ndryshim të ligjit të pagave mirëpo Ministria e Financave është e vetëdijshme për këtë edhe në takime edhe ne mbledhje na ka sugjeruar që ne me vepru sipas këtyre kufinjëve mirëpo kur të vjen momenti për me i ngritë pagat, me zbatua ligjin mbi pagat, atëherë ne e bëjmë diferencën pra ndryshimin, e plotësojmë pra drejtpërdrejt e rrisim këtë pozicion të pagave e tani për tani duhet caktuar këtë limit, do të thotë edhe këto doktor janë tavane buxhetore që janë të specifikuara me ligjin e Financave do të thotë ligjin e pagës.

Fehmi Cena – Te pagat, ky limit është maksimal që ju është lejuar komunës dhe ju e keni futur në blanko apo e keni bërë përlllogaritjen e saktë sa do të shpenzohen me 1 janar të vitit të ardhshëm, krejt punëtorët që i kanë komuna, se tash ajo rritje që mendohet prej 1 janarit me pas sipas ligjit që janë rritur rrogat, a është këtu apo do të jetë ajo shtesë, çka nëse hyn në fuqi ligji, se këtu ceket diku se kjo rritje është 13% e diçka, por ne e dimë se rrogat janë rritë me një përqindje më të madhe kanë thonë kështu, ligji për shëndetësi, kur e kemi përlllogaritur diku 40-50% ka rritje të rrogave dhe jo 13% për këto e dua një sqarim, a është rritë numri i punëtorëve në institucione shtetërore që për vitin 2018 ju mendoni që edhe 1.208.000 më shumë do të shpenzohen apo çka, mundeni ta sqaroni këtu, a është në pyetje ligji apo mendoni me rritë apo është ai limiti që ju e keni shfrytëzuar pastaj mundeni me zbrit.

Afrim Limani – Pyetje me vend doktor, unë mendoj se e sqarova por prapë ndoshta ma detajishtë. Këtë limit që figuron, pagat janë të analizuar sipas departamentit të Financave, ata për komunën e Rahovecit e kanë vlerësuar se kaq do të jetë limiti mirëpo ne, edhe ne dimë me përgatitë këto, pagat fillojnë me ligj të ri, ne i kemi katalogët me përshkrimin e vendit të punës, llogaritet ajo dhe del një shumë e caktuar edhe ajo shumë ne që e kemi llogaritë është më e madhe se sa i kemi limitet të caktuara nga Ministria e Financave, ata janë të vetëdijshëm për këto mirëpo ata i kanë hesapet e veta, i kanë llogaritë tash edhe njëherë telashe kur të vjen momenti i ekzekutimit të pagës, zbatimi i ligjit të pagave ndryshimi që i joni është më i madh, atë ndryshim ata do ta ekzekutojnë edhe s'ka kurrfarë problemi në këtë pikë, këtu është esenca. Pyetja tjetër ishte pse mallrat janë rritur se në vitin 2019, besoj që dhashë përgjigjen më herët, do të thotë e kanë rritur për çdo komunë të Republikës së Kosovës, për me i ikur keq klasifikimit, nëse është një shpenzim në kuadër të mallrave dhe shërbimeve pse me e hedh në investime kapitale sepse ajo drejtpërdrejt reflekton në pasqyra Financiare, gradimet në punë, kjo u përgjigj me atë se, ne e kemi një katalog që bëhet gradimi jo që shtohet absolutisht, se harrova me thënë kjo është më kryesore ky staf ekzistues që është por tash me ligje të ri të pagave ndryshojnë d.m.th. bëhet gradimi, tash me marr një shembull, janë disa kode diçka që qiten aty do të thotë kjo e ka atë kuptim. Subvencionet e Kryetarit, pse janë rritë? Subvencionet e Kryetarit në raport me vitin 2019 janë rritë diku për 6000 euro edhe konsideroj se edhe kjo është shumë e vogël në raport, duke ditur se sa kërkesa, sa nevoja paraqiten brenda një viti fiskal sepse Kryetari mundet ta mbulojë çdo shpenzim të investimeve kapitale kuptohet përmes një rregullore, që e kemi rregulloren për subvencione, edhe i kemi rritë subvencionet në bujqësi për 20.000 euro në raport me vitin e kaluar. Fahrija i bëri disa vërejtje, disa sugjerime, këto të gjitha i pranoj do të thotë edhe ja përcjelli edhe drejtorit, edhe për Dervishin ishte pyetja e njëjtë.

Rasim Fazliu-Faleminderit, pyetja është plehurat kimik a janë investim kapital? Faleminderit!

Afrim Limani –Nuk janë investim kapital dhe këtë mundem me korigjua në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor për sqarimet e dhëna, mendoj që u diskutua mjaft gjatë rreth pikës së 5 të rendit të ditës, konstatojmë se kalojmë për Kuvend pikën e 5 të rendit të ditës. Faleminderit shumë Kalojmë në pikën e 6 të rendit të ditës:

Shqyrtimi i planit strategjik komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Rahovec për vitin 2020-2024, për këtë pikë ftoj drejtorin Samir Mustafa!

Samir Mustafa – Përshendetje për të gjithë, të nderuar asambleistë, para jush kemi një plan strategjik komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor për Komunën e Rahovecit. Hartimi i këtij plani strategjik komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor për Komunën e Rahovecit, shërben si një dokument dhe urdhërrëfyes i politikave shëndetësor afatgjatë. Ky plan do të përdoret për zhvillimin e sistemit shëndetësor në komunën e Rahovecit. Ofrimi i shërbimeve sa më cilësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe krijimi i kushteve sa më favorshme për qytetarët e kësaj komune edhe qëllimi kryesor I i këtij Masterplani apo plani strategjik. Nevoja për planifikim të mirëfilltë në sektorin e shëndetësisë është identifikuar përmes analizave të situatës, me zbatimin e këtij plani do të mundësohet edhe arritja e misionit të Kujdesit Parësor Shëndetësor në Komunën e Rahovecit, ofrimin e shërbimeve sa më cilësore të vazhdueshme dhe të qasshme për të gjithë komunitetin. Të nderuar asambleistë, ju ftoj që ta votoni dhe ta miratoni këtë plan strategjik.

Kryesuesi - Faleminderit drejtor, urdhëro z.Fazliu!

Rasim Fazliu- Faleminderit kryesues, e falenderojmë drejtorin që na paraqiti planin strategjik komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor për komunën e Rahovecit 2020-2024, kisha menduar që këtë pikë me kalua në Kuvend dhe e diskutojmë pak më gjerësisht në qoftëse kolegët pajtohen, normalisht unë nuk jam ai që vendosi vetë. Faleminderit shumë.

Kryesuesi - Faleminderit z.Fazliu, të nderuar kolegë anëtarë të KPF-së a po pajtoheni me propozimin, urdhëro zj.Lushi!

Fahrie Lushi- Faleminderit kryesues, pajtohem plotësisht kështu që e përcjellim për mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi- Faleminderit shumë, konstatojmë që kalon për Kuvend pika e 6 e rendit të ditës, shqyrtimi i planit strategjik komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor, tani jemi në pikën e 7 të rendit të ditës,

Në të ndryshme – nëse dikush ka diçka, nëse jo kolegë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa ju falenderoj shumë për kontributin e dhënë. Faleminderit, shihemi në mbledhjen e Kuvendit .

Procedimbajtësi

Agim Hoti

